



Datë: 17.06.2025
Numër Protokolli: 4193/2025

A.nr.597/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.597/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi E.H, kundër organit të punësimit/Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datë 17.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.597/2025, e datës 03.04.2025 e parashtruar nga ankuesi E.H, ashtu që aprovohet pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00017525 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve, ndërsa refuzohet pretendimi për anulimin e Vendimit me Nr. Ref:07/2025 i datës 26.03.2025.

II. Anulohet konkursi me Nr. Reference: RN00017525 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit të bëjë zbatimin e tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi E.H, (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 03.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër caktimit të ushtrues të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Aerodromeve dhe kundër shpalljes së konkursit me Nr. Reference: RN00017525 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoritetit të Aviacionit Civil (*tutje referuar AAC*), ndërsa, ky i fundit, më datë 25.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2225/2025 të datës 0-3.04.2025 të parashtruar ngas ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të ankuesit; Vendimin e datës 21.03.2023 të ministrit të MMPHI; Vendimin Nr. Ref:20/2024 të datës 25.03.2024 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit të Aerodromeve; Kërkesën e datës 18.09.2024 të ankuesit për ud. Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së; Vendimin me Nr. 308 të datës 20.09.2024; Vendimin Nr. Ref:50/2024 të datës 25.09.2024 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit të Aerodromeve; Shkresën e datës 25.09.2024 nga u.d Drejtori i AAC për ankuesin; Emailin e datës 26.09.2024 nga ankuesi për B.D; Emailin e datës 25.09.2024 nga S.A për ankuesin; Kërkesë për shprehje të interesit për ushtrues detyre datës 21.03.2025 nga ankuesi për u.d Drejtorin e Përgjithshëm të AAC; Vendimin Nr. Ref:07/2025 të datës 26.03.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Aerodromeve; Emailin e datës 28.03.2025 nga S.,S për M.I, E.G dhe A.R; Konkursin për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin e datës 24.03.2025 të zëvendësuesit e të Drejtorit të Thesarit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 25.04.2025; Vendimin me Nr. 612462 të datës 18.04.2014 të MASHT; Diplomën e ankuesit 2009; Kërkesën për shprehje të interesit nga A.R dhe M.I e datës 24.05.2023; Vendimin me numër protokoll 3184/2025 të datës 15.05.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është pjesërisht e bazuar, **sepse:**

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 13.07.2012 është punësuar në pozitën *Inspektor i Aerodromeve* në Departamentin e Aerodromeve në AAC.

Tutje sipas shkresave të lëndës, u.d Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më datë 25.03.2024 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref: 20/2024 me të cilin z. A.R e ka caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Aerodromeve për një periudhë gjashtë (6) mujore. U.D Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më datë 25.09.2024 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref: 50/2024 me të cilin z. A.R e ka caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Aerodromeve për një periudhë gjashtë (6) mujore, ndërsa u.d Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më datë 26.03.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref: 07/2025 me të cilin z. A.R e ka caktuar ushtrues detyre i Udhëheqësit të Divizionit të Aerodromeve për një periudhë gjashtë (6) mujore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se caktimi i ushtruesit të detyrës është bërë në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërsa konkursi për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve është shapuar në kohën kur institucioni ka qenë në proces të ristrukturimit, dhe i njëjti kërkon të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i datës 26.03.2025, dhe të pezullohet konkursi deri në përfundim të procesit të ristrukturimit.

Kolegji i Këshillit, në bazë të shqyrtimit të provave materiale të lëndës, dhe pretendimit ankimore ndaj Vendimit me Nr. Ref:07/2025 i datës 26.03.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Aerodromeve, konstaton se bazuar në Vendimin me Nr. Ref: 20/2024 dhe Vendimin me Nr. Ref: 50/2024, fillimisht pozita e Drejtorit të Departamentit të Aerodromeve është mbajtur me ushtrues detyre dy herë nga gjashtë (6) muaj, e që sipas nenit 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të*, me çka nënkupton se pozita Drejtor i Departamentit është pozitë e kategorisë së mesme drejtuese, ndërsa AAC ka miratuar Rregulloren (AAC) Nr. 02/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e

Aviacionit Civil, ku sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje është paraparë edhe struktura organizative e AAC-së, si në vijim: *Struktura organizative funksionale dhe operative e AAC-së përbëhet nga: 1.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm; 1.2 Divizioni i Operimeve Ajrore; 1.3 Divizioni i Vlefshmërisë Ajrore dhe Licencimit të Personelit; 1.4 Divizioni i Aerodromeve; 1.5 Divizioni i Shërbimeve të Navigacionit Ajror; 1.6 Divizioni i Standardizimit dhe Legjislacionit në Aviacion; 1.7 Divizioni i Rregullimit Ekonomik të Aviacionit dhe 1.8 Divizioni i Sigurisë dhe Cilësisë*, në kuadër të kësaj pozitat e Departamenteve nuk janë parashikuar, e për rrjedhojë Këshilli i pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka mandat as kompetencë të shqyrtoj ligjshmërinë e rregulloreve përkatëse.

Duke marr parasysh strukturën organizative të AAC-së, Kolegji i Këshillit, konstaton se përmes Vendimit me Nr. Ref: 07/2025, të datës 26.03.2025 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, z. A.R është caktuar ushtrues detyre i Udhëheqësi të Divizionit të Aerodromeve, që në kuptim të nenit 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, është përcaktuar se kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të, kjo pozitë është pozitë e kategorisë së ulët drejtuese, e për rrjedhojë akti i kontestuar me ankesë nuk ka të bëjë me pozitë të kategorisë së njëjtë sikurse ka ndodhur me caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit të Aerodromeve sipas Vendimit me Nr. Ref:07/2025 i datës 26.03.2025 dhe Vendimit me Nr. Ref: 20/2024 dhe Vendimit me Nr. Ref: 50/2024.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh konstatimin si më sipër, vlerëson se caktimi i ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Aerodromeve, nuk është në kundërshtim me nenin 35 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj vendimit të kundërshtuar me ankesë janë të pabazuara.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ndaj shpalljes së konkursit me Nr. Reference: RN00017525 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve nga AAC, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur se AAC, ka shpallur konkursin në kohën kur ka qenë institucioni në procedurë të ristrukturimit, dhe për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kur institucioni është në procesin e ristrukturimit nuk mund të shpall konkurse dhe nuk mund të zhvilloj si të tilla pa përfunduar i tërë procesi i ristrukturimit ngase institucioni duhet të ketë parasysh parimet e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më konkretisht Kolegji mori për bazë dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave*, kështu që pretendimi i ankuesit në këtë aspekt është i bazuar, andaj në kuadër të konstatimeve si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së është i obliguar që të zbatoj këtë vendim duke respektuar në plotëni pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.597/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.H;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AAC; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.